



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të nenit 37 të Ligji nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë; neni 36 I Statutit të OSK-së dhe në varësi të rëndësisë, synimit dhe kohëzgjatjes së zgjidhjeve të çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me veprimtarinë stomatologjike të anëtarëve të saj, në mbledhjen e mbajtur me datë 29/12/2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PROFESIONAL TË OSK-SË

- I. Përbërja e Këshillit të ekspertëve profesional (KEP):
 1. Prof.Assoc. Dr. Ferit Koçani – kryesues
 2. Prof.Dr. Agim Begzati- anëtar
 3. Prof.Ass.Dr. Ali Gashi- anëtar
 4. Prof.Ass. Dr. Ngadhnjim Domi- anëtar
 5. Prof.Ass. Dr Jeta Kelmendi- anëtar
 6. Dr.sc. Kastriot Meqa- anëtar
 7. Dr. Merita Brovina- anëtar
 8. Dr. Nora Berisha- anëtar

- II. Fushëveprimi i KEP konsiston në ndihmesën e tyre nëpërmjet konsultave, informacioneve, opinioneve dhe shërbime të tjera për OSK-në, në të gjitha detyrat e saj që kanë të bëjnë me:
- përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave profesionale të anëtarëve të Odës në ushtrimin e profesionit;
 - kujdesin për ruajtjen e autoritetit të anëtarëve të Odave në ushtrimin e punëve profesionale në pajtim me etikën profesionale;
 - promovimin dhe mbrojtjen e aktiviteteve të profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike dhe private,
 - hartimin e strategjive, politikave dhe probleme kryesore, zgjidhja e të cilave ka rëndësi në procesin e veprimtarisë së ushtrimit të profesionit të anëtarëve të Odës.
- III. Në dispozicion të KEP, kur është e nevojshme, vihen ekspert që kanë dijeni për një fushë specifike, me aprovim të kryetarit të OSK-së.
- IV. Në rastet kur KEP, përballet me probleme që dalin jashtë fushës së kompetencave e përgjegjësi të tij, i drejtohen organit që e ka emëruar me shkrim për problematikën e hasur.
- V. Kompensimi i anëtarëve bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Kryesuesi i KD-së

Prof. Dr. Blerim Kamberi

